



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:052685

Datë: 18.10.2019

Numri i dokumentit: 00587282

P.nr. 157/2018

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th. nga Prizreni, aktakuzës **PP.II.nr.3149-2/17** të datës **26.03.2018**, ndaj të pandehurit E H nga S, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale shkreterim i pyjeve nga neni 357 par. 1 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të PTH-së, nga Prizreni Atnor Skoro dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur me dt.**14.10.2019** mori, publikisht shpalli dhe me date **18.10.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit E.H nga i ati J,e ema N e lindur E ,i lindur me dt.03.07.1956,me numër personal ----- ne fshatin B komuna S, tani jeton,i martuar,baba i 6 femijeve,ka te kryer shkollene e mesme,i gjendjes se mesme ekonomike,ne Suharekë, në lagjen F,rr.”H P”, pa numër, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës.

Konform nenit 363 par. 1 nën. Par. 1.1 të KP-së

REFUZOHET AKUZA

Sepse me dt.30.11.2017 ne ore te pa vërtetuar, në zonën kadastrale B komuna S, në vendin e quajtur “G-Ekonomija e pyjeve “B”, ne kundërshtim me ligjin ose me urdhrin e organit kompetente bën prerjen apo shkatërrimin e pyllit ose ne ndonjë mënyre tjetër shkreteron pyjet, në ngastrën me numër P-72116004-00...-0,prone e AKP-se ne atë mënyrë qe gjate hapjes se një kanali, dëmton 19 copë dru me diametër te përgjithshëm 0.63 m3.

Me këtë kishte për te kryer veprën penale shkreterimi i pyjeve nga neni 357 par. 1 i Kodit Penal.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barre te mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze, **PP.II.nr.3149-2/17** të datës **26.03.2018**, ndaj të pandehurit E H nga Suhareka, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale shkreterim i pyjeve nga neni 357 paragrafi 1 i Kodit Penal, te cilin gjatë seancës se shqyrtimit gjyqësor e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Atnor Skoro.

Në fundë shqyrtimit gjyqësor të dates **14.10.2019** në fjalën e vet përfundimtare prokurori i shtetit Atnor Skoro deklaroi se terhiqem nga akuza **PP.II.nr.3149-2/17** të datës **26.03.2018**, e parashtruar ndaj te pandehurit E H, meqense gjate administrimit te provave me asnje prove, nuk eshte vertetuar se i njejt ka kryer veper penale shkreterim i pyjeve nga neni 357 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata, pas tërheqjes së prokurorit nga akuza, përkatësisht nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurit E.H dhe ate për veprën penale shkreterim i pyjeve nga neni 357 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, morri aktgjykim refuzues.

Vendimin për lirim nga shpenzimet gjyqësore, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në baz të nenit 363 par 1 nën par.1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.